

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
KOMUNËN FSHAT TROPOJË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Komunën Fshat Tropojë**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë*”, lloji i auditimit: “*Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare*”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2012 deri 30.06.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 158, datë 03.12.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “*Për Kontrollin e Lartë të Shtetit*”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, date 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 769/7, datë 03.12.2014, i ka rekomanduar z. Ram Kortoçi, Kryetar i Komunës Fshat Tropojë, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.1 Gjetjet nga auditimi: Janë planifikuar shpenzime operative për mirëmbajtje objektesh, lysterje objektesh, dhe mirëmbajtje rrugësh, këto në mungesë të projekteve dhe preventivave përkatëse, ç’ka është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*”, i ndryshuar, neni 3, pika 4.

1.2 Rekomandimi: Të merren masat e nevojshme për zbatimin e buxhetit sipas kërkesave ligjore, konkretisht:

-të ndalohen praktikrat e kryerjes së shpenzimeve ndërtimore për mirëmbajtje të rrugëve, rikonstruksion të godinave riparime etj., në mungesë të projekteve dhe preventivat përkatëse, ç’ka është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*”, i ndryshuar, nenet 3 dhe 4.

-të ndalohen praktikrat e kryerjes të një zë punimi ndërtimor në disa kontrata, duke shmangur kufirin monetar për kryerjen me procedurën e tenderimit, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “*Për rregullat e prokurimit publik*”, i ndryshuar, kreu II, pikat 1/b dhe 1/c.

Në vijimësi

2.1 Gjetjet nga auditimi: Konstatohet se për vitet 2012, 2013 dhe 2014, për 20 subjekte të pa regjistruara, nuk ka gjetur zbatim të plotë ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, neni 41- Identifikimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare pa u regjistruar , ku në pikën 1, parashikohet se: “*Kur administrata tatimore identifikon persona, të cilët ushtrojnë veprimtari ekonomiko-tregtare pa u regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, atyre u mbyllet veprimtaria*”.

2.2 Rekomandimi: Komuna, të marrë masa për regjistrimin e subjekteve dhe të ndjekë hapat e nevojshme ligjore për arkëtimin e detyrimeve tatimore dhe të kontributeve për sigurimet shoqërore e shëndetësore, për 20 subjekte që kanë ushtruar aktivitet të pa licencuar.

Menjëherë

3.1 Gjetjet nga auditimi:

U konstatua se me vendime të Këshillit të Ministrave nr. 473, datë 16.4.2008 “*Për miratimin e listës paraprake të pronave të pa luajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Fshat Tropojë të Qarkut Kukës*” dhe VKM nr. 7, datë 07.01.2009 “*Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, Komuna Fshat Tropojë, të Qarkut Kukës*”, janë miratuar në administrim dhe në pronësi të komunës, prona përfshi këtu, pyje dhe kullota, të cilat nuk janë regjistruar në ZVRPP.

3.2 Rekomandimi:

Kryetari i komunës Fshat Tropojë, të krijojë një komision për pronat, të cilat me vendimin e Këshillit të Ministrave, kanë kaluar në pronësi të komunës. Të verifikohet statusi i tyre në terren dhe më pas të procedohet për regjistrimin e tyre në ZVRPP.

Menjëherë

4.1 Gjetja nga auditimi. Njësia e Prokurimit nuk ka përpiluar regjistrat e parashikimit dhe realizimit të prokurimeve për vitin 2012 dhe 2013 dhe nuk ka dërguar pranë Agjencisë së Prokurimit Publik asnjë nga regjistrat e parashikimit e të realizimit të prokurimeve të fondeve publike, sipas kërkesave të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu I, pika 3/d dhe për këtë mbajnë përgjegjësi anëtarët e Njesisë së Prokurimit.

4.2 Rekomandimi. Të përpilohet në zbatim të planit të buxhetit regjistri i parashikimit të prokurimeve publike dhe të ndiqet realizimi i tyre. Për prokurimet publike të realizuara të hartohet regjistri përkatës dhe të dërgohen periodikisht në Agjencinë e Prokurimit Publik.

Menjëherë

5.1 Gjetja nga auditimi. Në llogaritjen e fondit limit, për prokurimin “Ndërtimi i shkollës 9 vjeçare Gegaj Tropojë” ka mangësi pasi në të është përfshirë në përqindje kundrejt vlerës së objektit edhe vlera e hartimit të projektit, preventivit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit, në vlerën 488,920 lekë, veprim ky në kundërshtim pikën 3/1 dhe 4/c të udhëzimit nr. 1, datë 16.6.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar”. Duke llogaritur sipas preventivit edhe vlerën e fondit rezervë duhej që fondi limit i prokurimit me objekt “Ndërtim shkolla 9 vjeçare Gegaj Tropojë” të ishte më i vogël **në shumën 513,367** lekë, ose nga 8,998,770 lekë që është prokuruar të ishte 8,485,403 lekë.

Për sa më lart mban përgjegjësi Autoriteti Kontraktor dhe Njësia e Prokurimit, pasi ka vepruar në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” Kreun II pika 2 germa “c” e “ç”, ku thuhet:

Shpallja e tenderit me këto mangësi është reflektuar edhe në preventivin pa çmime e vlera të paraqitur në faqen elektronike në dokumentet e tenderit ku këto zëra që nuk janë punime, por që ju takojnë sipërmarrësit janë materializuar me vlera të llogaritura në përqindje ndaj vlerës së preventivit.

5.2 Rekomandimi. Në hartimin e situacionit përfundimtar të punimeve të kryera për objektin “Ndërtimi i shkollës 9 vjeçare Gegaj Tropojë” të zbritet vlera e hartimit të projektit e preventivit dhe vlera e mbikëqyrjes në shumën 420,230 lekë dhe vlera e kolaudimit në shumën 68,691 lekë, **gjithsej 488,920 lekë (pa TVSH)**, pasi për to detyrimi i Autoritetit Kontraktor është ndaj subjekteve të tjera me të cilat ka kontrata dhe sipërmarrësit ti likuidohet vetëm vlera e punimeve të ndërtimit, sipas zërave të preventivit fitues.

Menjëherë

6.1 Gjetje nga auditimi Në dokumentet e tenderit nga Njësia e Prokurimit nuk është kërkuar që operatorët ekonomikë të paraqesin pasqyrat financiar për 3 vitet paraardhëse, parashikuar në germën “c” të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, ku kërkohej paraqitja e dokumentacionit që të deklarohet: “Gjendja ekonomike e financiare: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilancet, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevojë, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur”.

6.2 Rekomandimi Nga Njësia e Prokurimit të cilësohet në dokumentet e tenderit kërkesa që operatorët ekonomikë të paraqesin vërtetim për gjendjen financiare, të dokumentuar atë me bilancet e pasqyrat financiar të 3 viteve paraardhëse, të konfirmuara ato nga organet kompetente, si drejtoritë rajonale të tatimeve.

Në vijimësi

7.1 Gjetje nga auditimi Janë kualifikuar operatorë ekonomikë pjesëmarrës në tender, njëkohësisht janë shpallur edhe fitues, të cilët nuk kanë vërtetuar me dokumente e analiza plotësimin e specifikimeve teknike dhe kërkesave për kualifikim të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

-Operatori ekonomik “A..A” sh.p.k., që është shpallur edhe fitues, ka mangësi në dokumentacionin kualifikues, pasi nuk përmbush kërkesën për të pasur në listë pagesat e sigurimeve shoqërore 1 inxhinier ndërtimi dhe 1 inxhinier elektrik e konkretisht, për vitin 2010 nuk ka asnjë inxhinier, në vitin 2012 mungon inxhinieri elektrik.

Puna e ngjashme e paraqitur nga operatori ekonomik është e para 3 vjetëve dhe me vlerë më të vogël se sa është kërkuar në dokumentet e tenderit. Vlera e punës së ngjashme të realizuar është 8,477,865 lekë, nga 8,998,770 lekë e kërkuar në dokumentet e tenderit.

Mungon dokumenti për të vërtetuar pasjen në pronësi, apo me qira të 4 betonierave.

Nisur sa më lart, **Operatori ekonomik “A..A” sh.p.k. duhej të ishte skualifikuar.** (Trajtuar më hollësisht në faqen 42-49, të Raportit të Auditimit).

7.2 Rekomandimi Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të vlerësojë drejt kërkesat për kualifikim dhe specifikimet teknike të miratuara në dokumentet e tenderit duke u mbështetur në plotësimin e tyre me dokumente zyrtare dhe fletë analiza të lëshuara nga organe kompetente.

Në vijimësi

8.1 Gjetje nga auditimi Në prokurimet e zhvilluara në vitin 2012 dhe në vitin 2013 për blerje dru zjarri për ngrohjen e shkollave në Komunën Tropojë, u konstatua se nuk ka argumentim, se si është llogaritur fondi limit, e konkretisht në tenderin e zhvilluar me procedurën me negociim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës në vitin 2012, ndaj dy procedurave të anuluar për mungesë pjesëmarrje të operatorëve ekonomikë, vërehet rritje e sasisë së druve të zjarrit me 34 m³ dhe e fondit limit për 203,402 lekë. Po kështu nuk evidentohet zgjedhja e çmimit për njësi në llogaritjen e fondit limit. E njëjta procedurë është zhvilluar edhe për vitin 2013.

Për sa më lart mban përgjegjësi Autoriteti Kontraktor dhe Njësia e Prokurimit, pasi kanë vepruar në kundërshtim me germa “c” e “ç” të pikës 2 Kreun II i VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”.

8.2 Rekomandimi Për një përdorim me efikasitet të fondeve publike të argumentohet domosdoshmëria e kryerjes së prokurimit me përcaktimin me përgjegjësi dhe nga persona kompetentë të sasive që do të prokurohen, me leverdinë ekonomike dhe volumet efektive të punëve që do të kryhen.

Në vijimësi

9.1 Gjetje nga auditimi Nuk ka urdhër të brendshëm që të vërtetojë që është caktuar nëpunësi autorizues, sipas përcaktimeve të nenit 8 paragrafi 3, 4, si dhe nëpunësi zbatues, sipas nenit 9, germa “ç” të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”. “Nëpunësi autorizues” duhet të jetë përgjegjës për zbatimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha strukturat, programet, aktivitetet dhe proceset që menaxhohen prej tyre në Komunë. Caktimi i nëpunësit autorizues dhe i nëpunësit zbatues evidentohet në shkresën nr. 531, datë 1.8.2012, drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Kukës dhe në informacionin drejtuar Degës së Thesarit në datën 6.1.2014, ku në të dy rastet Nëpunës Autorizues është kryetari i Komunës Tropojë dhe Nëpunës Zbatues, me detyrë përgjegjës i Zyrës së Financës. Pas ndryshimit të detyrës të këtij të fundit, nuk ka urdhër për caktimin e përgjegjës të financë si Nëpunës Zbatues.

- Nuk janë hartuar politikat për miratimin dhe monitorimin e objektivave të njësisë publike që ai drejton, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave.

- Nuk është ngritur grupi i menaxhimit strategjik të njësisë publike, i cili duhet të përbehet nga menaxheret kryesore të njësisë publike dhe të kryesohet nga titullari.

9.2 Rekomandimi Në funksion të menaxhimit financiar dhe kontrollit, titullari i njësisë publike, të caktojë me akt administrativ nëpunësin autorizues dhe nëpunësin zbatues, të hartojë politikat, të miratojë dhe monitorojë objektivat e njësisë publike që ai drejton, planet strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektiveve. Të ngrihet grupi i menaxhimit strategjik të njësisë publike, i cili të përbëhet nga titullari i njësisë publike dhe të kryesohet prej tij sipas ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Menjëherë

10.1 Gjetje nga auditimi Nuk janë hartuar dhe miratuar sistemet e menaxhimit të informacionit. Nuk janë ndjekur dhe nuk ka raportime te titullari i njësisë publike për statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, për riskun e mashtrimit e të parregullsive dhe të çdo mangësie serioze që pengon realizimin e objektiveve, ose risqe, për të cilat nuk janë adresuar nga njësia, masat korrektuese të marra dhe të përmbushura nga nivelet e menaxhimit të njësisë që drejton.

10.2 Rekomandimi Të ngrihet e miratohet një sistem për komunikimin dhe përcjelljen e informacionit ndërmjet sektorëve dhe eprorëve si pjesë e llogaridhënies, bashkëpunimit dhe e kontrollit të brendshëm, duke vendosur një sistem efikas të kontrollit të brendshëm.

Menjëherë

11.1 Gjetje nga auditimi Nuk janë ndarë përgjegjësitë që lidhen me vendimmarrjen, kontrollin, zbatimin dhe vendosjen e linjave të raportimit, në përputhje me përgjegjësitë, pasi nuk ka një rregullore të miratuar, ku të jenë përcaktuar detyrat e çdo punonjësi sipas kërkesave të vendit të punës dhe në mbështetje të detyrave që përcakton ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe të Kontrollit”. Rregullorja e Administratës së Komunës Fshat Tropojë është miratuar me vendimin e Këshillit të Komunës nr. 22, datë 28.5.2014, por përsëri në të nuk janë të përcaktuara detyrat, detyrimet e të drejtat për çdo vend pune.

11.2 Rekomandimi Të hartohet dhe të miratohet rregullore e brendshme mbështetur në kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar e kontrollin” dhe aktet e tjera në zbatim të tij, duke përshkruar kërkesat dhe detyrat për çdo vend pune në administratën e Komunës.

Brenda vitit 2014

12.1 Gjetje nga auditimi Nga auditimi konstatohet se janë evidentuar ndërtime pa leje ndërtimi, në të cilën vetëm në një rast është mbajtur procesverbal bllokim punimesh, ndërsa në rastet e tjera nuk është vepruar.

Gjithashtu në asnjë rast nuk janë aplikuar penalitete për ndërtime pa leje të konstatuara, në zbatim seksionin VII neni 82, pika 8 shkronja (a) të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 "Për planifikimin e territorit" ndryshuar me ligjin 110/2013, seksioni VII vëzhgimi, inspektimi, kundërvajtjet e dënimet, Neni 82, Kundërvajtjet administrative, pika 8 Kryerja e punimeve pa leje: a) pa pasoja në krijimin e shtesave në sipërfaqe e vëllim ndërtimor dënohet me gjobë nga 300 000 lekë, deri në 30 për qind të vlerës totale të punimeve të kryera pa leje.

12.2 Rekomandimi Komuna Fshat Tropojë, të bashkëpunojë me Inspektoratin Ndërtimorë Urbanistik të Qarkut Kukës, të marrë masat dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore në objektet e mëposhtëm:

1. Objekti “Bar-kafe”, me pronarë S.M. dhe adresë fshati Asta, për vlerën e gjobës 300,000 lekë.
2. Objekti “shërbimi” me pronarë S.M. dhe adresë fshati Asta, për vlerën e gjobës prej 300,000 lekë.
3. Objekti “shërbimi” me pronar A.Sh. dhe adresë fshati Asta, për vlerën e gjobës prej 300,000 lekë.
4. Objekti “banimi” me pronarë B.M. dhe adresë Sopot, për vlerën e gjobës 300,000 lekë.

Menjëherë

13.1 Gjetje nga auditimi Nga Komuna Fshat Tropojë, janë lëshuar leje ndërtimi (zhvillimi), pa bërë të mundur hartimin dhe miratimin e Studimeve Urbanistike Pjesore, masterplane të zhvillimit territorial dhe planeve të veprimit, veprime këto në mos përputhje me dispozitat e ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”.

13.2 Rekomandimi Komuna Fshat Tropojë, të marrë masa që vendimet për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi, si dhe i gjithë dokumentacioni shoqërues dhe detyrimet financiare, në të ardhmen të jepen duke zbatuar me korrektësi ligjin për planifikimin e territorit.

- Zyra e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban, për çdo rast të shqyrtojë dhe të paraqesë për miratim vetëm ato kërkesa për sheshe dhe leje ndërtimi, të cilat janë të shoqëruara me dokumentin e pronësisë (vërtetim pronësie, ose certifikatë pronësie e shoqëruar me hartën treguese dhe kartelën e pasurisë së paluajtshme), të rifreskuar, brenda muajit të fundit.

Në vijimësi

14.1 Gjetje nga auditimi Konstatohet se dokumentacioni përfundimtarë që ndodhet në dosjet përkatëse, nuk është i sistemuar dhe i inventarizuar, në mospërputhje me nenin 24, germa b, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” si dhe të nenit 4 dhe 5 kapitulli II mbi “Detyrat e sekretarit-arkivit të organit shtetërorë” të “Rregullores për punën me dokumentet administrative të organeve shtetërore.

14.2 Rekomandimi Zyra e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban, për çdo dosje të sistemojë dhe inventarizojë dokumentacionin përfundimtar, që ndodhet në dosjet përkatëse të lejeve të zhvillimit dhe shfrytëzimit.

Në vijimësi

15.1 Gjetje nga auditimi Nga auditim konstatohet se nuk është mbajtur Regjistri i Planifikimit të Territorit në portalin web të regjistrit elektronik, si një rrjet i integruar dhe shumë funksional për shkëmbimin elektronik të informacionit i cili shërben për të ruajtur, mirëmbajtur, administruar dhe përditësuar në mënyrë të pavarur të dhënat, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit.

15.2 Rekomandimi Zyra e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban të regjistrojnë të dhëna përkatëse, duke krijuar regjistrin e planifikimit të territorit, për territorin që administrojnë.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar, kreu IV, nenet 9-14, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109, nga Komuna Fshat Tropojë të nxirren aktet administrative, të kryhen kontabilizimet dhe të kërkohet shpërblimi i dëmit në vlerën 20,792,566 lekë, si më poshtë:

1.1 Gjetjet nga auditimi: Për vlerën **17,403,883 lekë**, për sa nuk është llogaritur dhe ndalur penalitet për subjektin “H... 1” shpk për shkelje të afatit të dorëzimit të punimeve të objektit “Rikonstruksion i murit rrethues dhe çatisë, shkolla 9/vjeçare Kërrnaje”, për vlerën 1,047,101 lekë, në shkelje të nenit 6/2 të kontratës së lidhur midis palëve datë 28.7.2011 dhe subjektin “A..A” shpk për shkelje të afatit të dorëzimit të punimeve të objektit “Rikonstruksion i shkollës së mesme Tropojë” për vlerë dëmi 16,356,782 lekë, në shkelje të nenit 6/2 të kontratës së lidhur midis palëve datë 09.9.2011 dhe ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil”, i ndryshuar.

1.2 Rekomandimi: Për vlerën **17,403,883 lekë**, për sa nuk është llogaritur dhe paguar kamat vonesë për subjektin “H... 1” shpk me vlerë dëmi 1,047,101 lekë dhe për subjektin “A...A” shpk me vlerë dëmi 16,356,782 lekë.

Deri në datën 31.3.2015

2.1 Gjetjet nga auditimi: Për vlerën **2,665,523 lekë**, në shkelje të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, UKM nr. 1, datë 16.6.2011 për disa ndryshime në UKM nr 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit pika 3.1 dhe pika 4, germa c, janë likuiduar vlerat e projektit, preventivit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit për objektin “Rikonstruksion i shkollës së mesme Tropojë” në favor të subjektit ndërtues “A...A” shpk.

2.2 Rekomandimi: Për vlerën **2,665,523 lekë**, në ngarkim të subjektit ndërtues “A...A” sh.p.k., për sa është likuiduar për projekt, preventiv, mbikëqyrje dhe kolaudim për objektin “Rikonstruksion i shkollës së mesme Tropojë”, vlera që ju takojnë subjekteve të tjera.

Deri në datën 31.3.2015

3.1 Gjetjet nga auditimi: Për vlerën **600,000 lekë**, rezulton se janë kryer shpenzime për aktivitete social kulturore ekskursion i këshilltarëve dhe aktivitete me rastin e festave të fundvitit, në shkelje të kërkesave të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, Kreu IV, neni 10/II, germat a, b, c, nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kreu VI, neni 49, pika 3, VKM nr. 243, datë 15.5.1995 “Për shpenzime për pritje, përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja”, i ndryshuar pika 1, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap. III, pikat 34, 35/a dhe 35/b dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

3.2 Rekomandimi: Për vlerën **600,000 lekë**, për sa janë likuiduar shpenzime për aktivitete të bëhen ndalesat ndaj personave të evidentuar në pasqyrën nr. 1 dhe pasqyrën nr. 2.

Deri në datën 31.3.2015

4.1 Gjetjet nga auditimi: Për vlerën **96,760 lekë**, në disa raste, janë skualifikuar operatorët ekonomik me ofertë më të ulët, pa u argumentuar ligjërisht, veprim ky në shkelje të kërkesave të nenit 56, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

4.2 Rekomandimi: Për vlerën **96,760 lekë**, të përgjigjen anëtarët e Komisionit të Prokurimit me Vlera të Vogla, të cilët kanë skualifikuar operatorë ekonomik konkurrentë që kanë paraqitur oferta me vlera më të vogla:

z. M.M. për 32,253 lekë.

z R.M. për 32,253 lekë.

z F.P. për 32,253 lekë.

Deri në datën 31.3.2015

5.1 Gjetjet nga auditimi: Për vlerën **26,400 lekë**, pasi nuk është mbajtur në burim tatimi mbi të ardhurat dhe nuk është derdhur në buxhetin e shtetit, për punonjësën e përforcuesit televiziv z. Miftar Çela, veprim ky në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Tatimi mbi të Ardhurat” me ndryshime, neni 9, pika 2.

5.2.Rekomandimi: Për vlerën **26,400 lekë**, për sa nuk është ndalur dhe derdhur tatim mbi të ardhurat për pagesën për punonjësën të përforcuesit televiziv për z. M.Ç. për 26,400 lekë.

Deri në datën 31.3.2015

C. MASA DISIPLINORE

-Mbështetur në kreun IV, neni 11, germa “e” dhe “ç” dhe nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe kontratës individuale të punës, i rekomandojmë Kryetarit të Komunës, fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore:

“Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” për punonjësit:

1. Z. M.M. me detyrë ish përgjegjës i zyrës së Financës

-Për moszbatim të procedurave ligjore në hartimin dhe zbatimin e buxhetit të komunës, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 19, pikat 4 dhe 5, ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 27, UMF nr. 2, datë 6.2.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit 2012” dhe UMF nr. 1/1, datë 19.2.2013 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2013”.

-Për sa nuk është mbajtur në burim tatimi mbi të ardhurat dhe nuk është derdhur në buxhetin e shtetit, për punonjësin e përforsuesit televiziv z. M.Ç. veprim ky në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Tatimi mbi të Ardhurat” me ndryshime, neni 9, pika 2.

-Për sa ka autorizuar kryerjen e shpenzimeve për pritje dhe përcjellje në 2 raste për shumën 600,000 lekë, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 243, datë 15.5.1995 “Për shpenzime për pritje, përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja” i ndryshuar pika 1 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap. III, pikat 34, 35/a dhe 35/b.

-Për sa nuk është llogaritur dhe ndalur penalitet për subjektin “H... 1” sh.p.k. për shkelje të afatit të dorëzimit të punimeve të objektit “Rikonstruksion i murit rrethues dhe çatisë, shkolla 9/vjeçare Kërrnaje”, për vlerën 1,047,101 lekë, në shkelje të nenit 6/2 të kontratës së lidhur midis palëve datë 28.7.2011 dhe subjektin “A..A” sh.p.k për shkelje të afatit të dorëzimit të punimeve të objektit “Rikonstruksion i shkollës së mesme Tropojë” për vlerë dëmi 16,356,782 lekë, në shkelje të nenit 6/2 të kontratës së lidhur midis palëve datë 09.9.2011 dhe ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi civil i Republikës së Shqipërisë”,

2. Z. Z.H. me detyrë përgjegjës i zyrës së urbanistikës.

-Në shkelje të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, UKM nr. 1, datë 16.6.2011 për disa ndryshime në UKM nr 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit pika 3.1 dhe pika 4, germa c, janë likuiduar vlerat e projektit, preventivit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit për objektin “Rikonstruksion i shkollës së mesme Tropojë” në favor të subjektit ndërtues “A..A” shpk

-Janë lëshuar leje ndërtimi (zhvillimi), pa bërë të mundur hartimin dhe miratimin e Studimeve Urbanistike Pjesore, masterplane të zhvillimit territorial dhe planeve të veprimit, veprime këto në mos përputhje me dispozitat e ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”.

3. Z. F.P. me detyrë jurist, anëtar i njësisë së prokurimit.

4. Z. R.M. me detyrë inspektor i pritjes së popullit dhe anëtar i njësisë së prokurimit.

Nga Njësia e Prokurimit nuk janë përpiluar regjistrat e parashikimit dhe realizimit të prokurimeve për vitin 2012 dhe 2013 dhe nuk ka dërguar pranë Agjencisë së Prokurimit Publik asnjë nga regjistrat e parashikimit e të realizimit të prokurimeve të fondeve publike, sipas kërkesave të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu I, pika 3/d dhe për këtë mbajnë përgjegjësi anëtarët e Njesisë së Prokurimit.

Në prokurimet e zhvilluara në vitin 2012 dhe në vitin 2013 për blerje dru zjarri për ngrohjen e shkollave në Komunën Tropojë, u konstatua se nuk kanë argumentim, se si është llogaritur fondi limit.

5. Z. H.N. nënkryetar dhe kryetar i KVO-së

6. Z. A.N. përgjegjëse e ndihmës ekonomike dhe anëtare e KVO-së

Kanë kualifikuar operatorë ekonomikë pjesëmarrës në tender, njëkohësisht janë shpallur edhe fitues, të cilët nuk kanë vërtetuar me dokumente e analiza plotësimin e specifikimeve teknike dhe kërkesave për kualifikim të përcaktuara ne dokumentet e tenderit

7. Z. S.T. me detyrë Inspektor i Tatimeve.

-Për mos veprim në vjeljen e tatim taksave vendore, për vitet 2012,2013 dhe 6 mujorin e vitit 2014, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore” me ndryshime, ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” me ndryshime, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Lokale” me ndryshime.

8. Z. A.G. më detyrë inspektor i ZMMT-së.

Për mos kryerjen e veprimeve të nevojshme ligjore për regjistrim në ZVRPP të pronave që kanë kaluar me VKM në pronësi të komunës, në kundërshtim me kërkesat e ligjit “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, nenet 9, 10, 13 dhe UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap. III, pika 30, 35/a.

9. Z. N.M. me detyrë polic i komunës.

10. Z. Sh.T. me detyrë polic i komunës.

Për mos përmbushjen e detyrimeve dhe kërkesave të ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë të bashkisë dhe të komunës”, ndryshuar, nenet 15, 35.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Përparim Gjuzi, Vasillaq Gjuzi dhe Kristaq Gjurgjaj më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Luljeta Nano, Sekretar i Përgjithshëm.